

Të nderuar Zotërinj të Shtetit dhe Qeverisë Shqiptare,

Ne jemi organizata të shoqërisë civile të cilat, të mbështetura nga dhjetra mijëra njerëz në Europë, punojmë me ata, të cilët janë më pak të privilegjuar për të siguruar ndihmat bazike dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Duke parë një tendencë të theksuar të ngritjes së një rryme populizmi ksenofobik në Evropë dhe botë, ky Apel, i drejtohet udhëheqjes së vendit, për të mbështetur të drejtat dhe vlerat që janë themeluese të parimeve të Bashkimit Europian për 60 vjet. Së bashku, ne kemi nevojë për të parandaluar shqetësime legjitime në lidhje me menaxhimin e migracionit, për të parandaluar pengesat e tij që do të shkojnë në disfavor të projekteve Europiane.

Cdo ditë, ne jemi dëshmitarë të një solidariteti të gjerë me njerëz të cilët janë duke i ikur luftërave brutale, persekutimit, shkeljeve të të drejtave të njeriut, jostabilitetit dhe varfërisë të tejskajshme. Në Europë edhe në botë, ne shohim njerëz të cilët mirëpresin refugjatë dhe emigrantë në komunitetet e tyre; njerëz të cilët hapin shtëpitë e tyre dhe dhurojnë para, sende materiale dhe çfarëdo tjetër që mund t'iu vijë në ndihmë. Vetëm këtë javë, shumë prej tyre kanë udhëtuar për në Bruksel për të mbështetur angazhimet tuaja për të zhvendosur azilkërkuesit nga Greqia dhe për të mbështetur planin "Sillini Këtu". Gjithashtu dëgjojmë njerëz të shprehin shqetësimet e tyre për të ardhmen, duke iu kërkuar qeverive të tyre të marrin vendime për t'iu përgjigjur ardhjes së një numri të madh njerëzish.

Ne krenohemi për angazhimin Europian në të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut dhe e drejtojmë vëmendjen tek ju për të nxitur dhe promovuar këtë angazhim brenda dhe jashtë vendit. Kur një numër i madh njerëzish në nevojë erdhën në verën e vitit 2015, Europa nuk arriti dot në një zotim të përbashkët për t'iu përgjigjur në mënyrë njerëzore, dinjitoze dhe në solidaritet me vendet e tjera. Sot e kësaj dite, vendet Europiane nuk janë të gatshme të përgjigjen në përputhje me detyrime e tyre sipas ligjit ndërkombëtar dhe Europian, dhe kështu, i mbajnë njerëzit larg vëmendjes.

Ne ju dëgjojmë të përsëritni zotimin tuaj ndaj vlerave Europiane – respekt për dinjitetin njerëzor, liri, demokraci, barazi, dhe fuqia e ligjit të të drejtave të njeriut. Por ne presim të shohim produktet e ketyre zotimeve në veprim. Shumë udhëheqës kanë punuar për të ndaluar njerëzit të shkelin në Europë, duke rrezikuar kështu ata që vërtet kanë nevojë për këtë arratisje.

Ju keni përgjegjësinë të rregulloni migracionin në mënyrë të ndershme, gjë e cila do të adresojë në mënyrë legjitime shqetësimet e qytetarëve. Ky duhet të jetë princip i bazuar në fakte, jo vetëm në retorikë populiste. Fuqia nuk është t'iu kthesh krahët atyre që kanë nevojë. Fuqia është t'iu tregosh rrugën e cila mban lart vlerat njerëzore.

Nëse BE dhe shtetet anëtare duan të mbeten aktorë të besueshëm ndërkombëtarë, nuk mund të presin vende si Turqia, Jordania dhe Libani të mirëpresin miliona refugjatë, ndërkohë që i dëbojnë ata drejt kufijve të BE-së, ose i lenë refugjatët në kushte çnjerëzore, siç ka ndodhur në ishujt Grekë, përgjatë Ballkanit Perëndimor apo në zona konflikti të pakontrolluara, si Libia. Vendimet tuaja janë me pasoja të rënda, jete ose vdekje, e nëse ju vazhdoni të ulni standartet, vendet anembanë globit do të ndjekin shembullin tuaj.

Në vend që të bëjë llogarinë se sa rritet numri i populistëve ksenofobë, veprimi i Europës ka qënë më shumë një kopje e këtyre modeleve. Por një qasje e bazuar në mbylljen e kufijve nuk mund të shkelë një politikë afatgjatë dhe efektive. Ne presim njerëz të aftë politikisht që qëndrojnë fort për dinjitetin njerëzor dhe që kujdesen që njerëzit të kenë më pak frikë, në vend që ta nxisin frikën. Ne presim politika të qëndrueshme dhe afatgjata migracioni, që garantojnë respektimin e të drejtave të njerëzve, në vend që t'i shtojnë ata drejt rrezikut. Këto përfshijnë vendime të rregullta dhe të sigurta drejt Europës, siç janë vizat humanitare, hapësirat e risistemimit dhe përmirësimit të qasjes në skemat e ribashkimit familjar, si edhe ngritjen e lëvizjes së punëtorëve nëpërmjet aftësive të tyre profesionale. Shqetësime të tjera globale, si konfliktet dhe mungesa e stabilitetit, varfëria, pabarazia dhe efektet e ndryshimeve të klimës, duhet të qëndrojnë në krye të axhendës europiane.

Ju dhe qeveritë tuaja duhet të vlerësoni ndikimin e politikave tuaja për të drejtat e njeriut dhe kushtet e jetesës së grave, burrave dhe fëmijëve në lëvizje, si dhe angazhimin e gjatë europian për t'i mbajtur këto të drejta në këmbë dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve kudo.

Në prag të përvjetorit të 60-të Bashkimit Evropian, ne ju kërkojmë të tregoni solidaritet, përgjegjësi dhe respekt për dinjitetin njerëzor. Ne kërkojmë që ju të jeni udhëheqës të vërtetë frymëzues për të ardhmen. Angazhimi ynë për vlerat thelbësore të Bashkimit Evropian nuk mund të ulet. Vetëm një Europë që me të vërtetë qëndron fort në vlerat e saj, mund të jetë një udhërrëfyes e fortë dhe e besueshme në një botë të tronditur nga rritja e populizmit dhe e të ashtuquajturave fakte alternative.

Historia Europiane është e mbushur me njerëz të cilët u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre për shkak të luftës dhe persekutimit. Puna që kanë bërë shtetet Europiane për të zhvilluar dhe mbrojtur të drejtat e njerëzve gjatë 70 viteve të fundit, nuk mund të humbasë.

Vetëm një Europë që mbron të drejtat e secilit, pa përjashtim, është një Europë me të cilën mund të krenohemi.